



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 10.04.2023
Nr. Prot 3597

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".
2. Projektvendim "Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Miratimi i këtyre projektvendimeve është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacionet shoqëruese.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

